
**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“Multi Service 2022” Sh.p.k.**

AKT THEMELIMI “Multi Service 2022”



Pag. 1 a 5

AKT- THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“Multi Service 2022” Sh.p.k.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “Multi Service 2022” Sh.p.k. dhe zoterohet nga ortaku:

- 1. Gjergji Ristani**, atesia . Panajot , shtetas shqiptar, lindur me 12.06.1983 ne Tirane , banues ne Tirane,identifikuar nepermjet kartes se identitetit Nr. I30612138U

Në përputhje me vullnetin e tyre te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendoset të hartojnë këtë akt themelimi të shoqërisë “Multi Service 2022”Sh.p.k. mbi bazen e ketyre principeve:

NENI 1
FORMA DHE EMRI

Shoqëria ka formen e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me initiale SH.P.K., dhe i perballon humbjet deri ne kufirin maksimal te vleres se kontributit te ortakeve ne kapitalin themeltar. Emri i shoqerise eshte “Multi Service 2022” Sh.p.k.

NENI 2
BAZA LIGJORE

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe qe do te ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

NENI 3
SELIA

Selia e shoqerise eshte ne adresen: TIRANE Njesia Administrative nr 5, Rruga Brigada VIII, Godina nr 23, Hyrja 4, Kodi Postar 1019.Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.



Me vendim te asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë sipas fushave ne te cilat e ushtron veprimtarine shoqëria.

NENI 4

KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit ne organin kompetent. Shoqëria priset me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakeve ose kur ka prishje të hershme për arsyet e parashikuara nga ligji.

NENI 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria “Multi Service 2022” Sh.p.k. është e organizuar në formën e një shoqërieprodhimi dhe realizimi software dhe ka si objekt të veprimtarise së saj:

5.1 Konsulenca te ndryshme.

5.2 Konsulence per marketing / komunikim / konsultim multimedial përfshirë edhe markat (branding), zhvillimin e planit te marketingut dhe komunikimit.

5.3 Shoqeria gjithashtu mund të kryejë, në përputhje me ligjin, të gjitha ato akte të dobishme ose të përshtatshme dhe gjykime ekskluzive të organit administrativ, për zbatimin e qëllimit të shoqerise, si për shembull:

- marrin pjesë në tenderë publikë dhe privatë;
- te jete pjesmarrese ne konsociume, ose bashkime edhe te perkohshme shoqerise;
- të marrë dhe të japë garanci, komisione, përfaqësime dhe mandate;
- të lëshojnë garanci në favor të palëve të treta;
- dhe në përgjithësi, në mënyrë dytësore dhe në mënyrë të rastësishme, kryejnë të gjitha transaksionet e tjera tregtare, industriale, të pasurive të patundshme, letrave me vlerë dhe financiare që organi administrativ e konsideron të nevojshëm, të dobishëm ose të përshtatshëm për zbatimin e qëllimeve shoqërore.

5.4 Tregtia, në çdo formë të pranuar, të produkteve dhe shërbimeve që lidhen me atë që ekspozohet, dhe në veçanti mjete te ndryshme transporti dhe pune.

5.5 Pjesëmarrja dhe përfaqesimi tregtare nga prodhuesit vendas ose të huaj edhe në ata sektore të krahasueshem me objektin themelor të shoqerisë.



5.6 Shoqeria mund edhe të zhvilloje aktivitete shërbimesh, cdo lloj operacioni ose investimi në sektorin pasuri të tundshme, pasuri të patundshme, fiandare, tregtare, leshimin e miratimeve, garanci dhe koncesion të hipotekës, duke formuar, marrë pjesë ose duke u bashkuar në ndonjë formë në shoqëri të tjera duke pasur objektiva të ngjashme, të lidhura ose plotësuese me to.

NENI 6 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 Leke (njqindmije), i ndare në 1 (nje)pjese. Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

1- Gjergji Ristani	100 % - 100.000 LEKE
---------------------------	-----------------------------

Kapitali themeltar i shoqërise do të shlyet tërësisht dhe depozitohet ne nje llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.

NENI 7 AKTET E SHOQERISE

Shoqeria do te rregullohet, perveç këtij akt-themelimi edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërise dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërise.

NENI 8 ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të shoqërise do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori. Si rezultat i ndryshimeve që mund t'i ndodhin kompanisë në të ardhmen dhe rritjes së numrit të ortakeve, tani dhe me vone, trupi që mban kapitalin aksionar të kompanisë do t'i referohet termit "Asambleja e Ortakeve". Shoqeria mund te percaktoje me shume se nje Administrator. Në çdo rast, kur termi "Administrator" përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërise "Multi Service 2022" Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer.

Përveç organeve të parashikuara më sipër Asambleja e Ortakëve mund të krijoje edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të



përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre. Administrator i shoqërise për një periudhë 3 (tre) vjeçare deri me 31/12/2025 është emeruar Z. **Gjergji Ristani**, identifikuar nga Karta Identitetit Nr. I30612138U

NENI 9

DISPOZITAT E FUNDIT

Çdo mosmarrveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zhgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë.

Ky akt themelim është hartuar në 2 (dy) kopje, duke patur secili kopje fuqi të njëjtë ligjore.

Tirane, 21/10/2022

**ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE
“Multi Service 2022” Sh.p.k.**

Gjergji Ristani

